



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr 743 Prot

Tiranë, 31 Korrik 2015

Ftesë për pjesëmarrje në Konferenca e IV-t Shkencore të KLSH-së :

“Risku dhe Auditimi”

Kontrolli i Lartë i Shtetit do të organizojë Konferencën e IV-t Shkencore vjetore në dhjetor të këtij viti, e cila do të trajtojë si temë kryesore :

“Risku dhe Auditimi” (Risku në fusha të ndryshme si ekonomike, politike, juridike, shoqërore dhe ambientaliste)

Aspektet mbi të cilat mendojmë të fokusojmë debatin shkencor do të jenë :

- Auditimi anti-korrupsion dhe vlerësimi i riskut institucional;
- Analiza e riskut në auditimin e tenderave publike;
- Vlerësimi i riskut në planifikimin e auditimeve;
- Vlerësimi i riskut në fushën e ekonomisë dhe vecanërisht në sektorët e burimeve natyrore, pasurive kombëtare, burimeve financiare, monetare, etj.;
- Identifikimi i risqeve në punën audituese dhe vlerësimi i mundësisë së ndodhjes dhe impaktit të tyre;
- Risku shoqëror dhe njerëzor dhe impakti i tyre në vendimmarrje, reforma (arsim, shëndetësi, etj), kontrata të llojeve të ndryshme, etj.;
- Përditësimi i check-listës së kriterëve për vlerësimin e riskut në auditim;
- Krahasimi i eksperiencave të ndryshme në përgatitjen e planit të auditimeve bazuar në risk .

Shprehja konkrete e interesit , të cdo specialisti të fushës së auditimit, ekonomisë, jurisprudencës (institucione akademike, universitare apo shoqatave profesionale të fushës) dhe më gjerë lidhur me tematikat e cituara me sipër, apo edhe për ndonjë çështje tjetër që do të gjykohet e arsyeshme nga të interesuarit, do të ishte një kontribut i vlerësuar dhe i mirëpritur për konferencën.

Ashtu si edhe në Konferencat e mëparshme të organizuara nga KLSH, edhe në këtë Konferencë janë të ftuar të marrin pjesë përfaqësues të SAI-ve partnere, personalitete të njohura dhe me eksperience nga Institucionet Supreme të Auditimit nga vende të Evropës, përfaqësues të institucioneve donatore, shtetërore, botës akademike dhe shoqërisë civile.

Komunikimi i mëtejshëm lidhur me Konferencën për të gjithë të interesuarit mund të realizohet në këto adresa : bleskaj@klsh.org.al dhe iislami@klsh.org.al).

Shprehja e interesit për pjesëmarrje dhe materialet paraprake duhet të dërgohen brenda datës 15 tetor 2015.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Bujar LESKAJ

